


Nr. ProtDate 17.03.2011

KERKESE**Drejtuar:** Qendra Kombetare e Regjistrimit (QKR)**Objekti:** Afishimi i njoftimit per mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "ARCO" Sha, me NIPT K11526009A, me drejtor z. Vitorio Catanese.**Baza liqjore:** Neni 141/a i Kodit te Procedures Civile**Z.Kola,**

Une Rezart Taci, ne cilesine e Administratorit te shoqerise "ARMO" Sha, ju bej me dije se Shoqeria "ARMO" Sha zoteron 45% te aksioneve te shoqerise "ARCO" Sha, me NIPT nr. K11526009A, shoqeri e cila referuar ekstraktit historic te QKR te dates 25.02.2011 rezulton se eshte me status "AKTIV".

Duke qene se shoqeria "ARCO" Sha nuk ka zhvilluar aktivitet normal nga dita e themelimit te saj e deri me sot, nepermjet njoftimit nr. 188, te dates 17.3.2011 i kemi kerkuar drejtorit te saj, z.Vitorio Catanese, mbledhjen urgjente te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "ARCO" Sha (njoftimi bashkelidhur), me objekt :Prishjen e shoqerise dhe celjen e procedurave te likujdimit.

Persa me siper, ne baze te nenit 141/a te K.Pr. Civile (njoftimi per personat juridik), kerkoj nga ana Juaj afishimin e ketij njoftimi prane sporteleve tuaja, me qellim venien ne dijeni te subjektit "ARCO" SHA per daten e sakte te kesaj mbledhje.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Shoqeria "A.R.M.O." Sh.a.

Perfaqesuar nga

Rezart TACI

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and lines, positioned over the printed name "Rezart TACI".

Nr. 199 Prot

Date 17.03.2011

NJOFTIM

Drejtuar: Shoqerise "ARCO" Sha, me NIPT nr.K11526009A

z. Vitorio Catanese

Drejtor

Objekti: Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te shoqerise "ARCO" Sha

Adresa: Rr: "Sami Frasheri", Nr.33 - Tirane

Z.Catanese,

Une Rezart Taci, Administrator i shoqerise "ARMO" Sha, ne cilesine e aksionarit dhe zoteruesit te 45% te aksioneve te shoqerise "ARCO" Sha, ne baze te nenit 6 te statutit te shoqerise dhe dispozitave te legjislacionit tregtar, kerkoj urgjentisht nga ana Juaj mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "ARCO" Sha me date 04.04.2011, ora 11.00, ne adresen "Deshmoret e 4 Shkurtit, Sky Tower, 4/2 Tirane (prane zyrave te Taci Oil) per te diskutuar, shqyrtuar dhe marre vendime ne lidhje me rendin e dites me objekt:

-Prishjen e shoqerise "ARCO" Sha, me NIPT nr.K11526009A si dhe çeljen e procedurave te likuidimit per kete kompani si pasoje e mosfunksionimit normal te veprimtarise se shoqerise per nje periudhe te gjate kohe;

-caktimin e nje likuidatori per qellimin e mesiperem.

Gjithashtu, ju mund te terhiqni nje kopje te dokumentacionit persa i perket problematikes se rendit te dites te mesiperme prane zyres, ku do te zhvillohet mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "ARCO" Sha.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Shoqeria "A.R.M.O." Sh.a.

Perfaqesuar nga

Rezart TACI

